



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 30
Prishtinë, 03 shkurt 2009, ora 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Teuta Hadri, Flora Brovina, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylaj, Bujar Bukoshi dhe Qamile Morina..

Munguan: Rita Hajzeraj dhe Sllobodan Petroviq

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale për vitin 2009;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen lidhur me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale për vitin 2009

Sadik Idriz – Tha se drafti i planit të punës së komisionit, është hartuar në përputhshmëri me strategjinë legjislativë. Në plan të punës janë përfshirë të gjitha ligjet që janë paraparë në strategjinë legjislativë, bisedë me ministrat e të dy ministrive, të cilat janë në kompetencë të komisionit për shëndetësi, vizita brenda dhe jashtë vendit. Nuk kemi planifikuar monitorim të ligjeve, sepse plani i punës është shumë i ngarkuar për këtë vit. Hap diskutimin.

Mimoza Ahmetaj – Tha se në plan të punës figuron Ligji për inspektoratin e punës si dhe Ligji për skemën e ndihmës sociale. Këto ligje janë amendamentuar vitin e kaluar. Ajo pyeti pse këto ligje janë kthyer prapë për amendamentim?

Armend Zemaj – Tha, sa i përket Ligjit për inspektoratin e punës, ky ligj është proceduar për amendamentim, me qëllim të harmonizimit me Ligjin për administratën tatimore dhe procedurën, i cili është ndryshuar.

Gjylnaze Syla – Lidhur me planin e punës propozoi që në muajin shkurt të ftohen: ministri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe ministri i Ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale, sepse sipas strategjisë legjislativë shumica e ligjeve janë plotësim – ndryshime dhe Komisioni duhet të ketë informatat e nevojshme. Nuk mund të bëjmë ndryshime të një ligji, pa e parë se sa po zbatohet në teren ai ligj, p.sh. nuk kemi njohuri se sa po zbatohet Ligji për duhanin. Në planin e punës pika objektivat e komisionit, pika e 4-të thotë: “komisioni do të zgjedh së paku një ligj në juridiksionin e tij për ta monitoruar”. Nëse objektivi e komisionit është monitorimi, atëherë komisioni duhet të bëjë monitorimin e dy ligjeve, një në sesionin pranveror nga fusha e shëndetësisë dhe një në sesionin vjeshtor nga fusha e punës dhe mirëqenies sociale.

Teuta Hadri – Tha se Komisioni ka bërë një punë të palodhur, mirëpo pengesë shumë e madhe ka qenë realizimi i objektivave të komisionit dhe i politikave shëndetësore nga ana e Ministrisë. Propozoi që në plan të punës të futet krijimi i një grupi punues brenda komisionit i cili do të merret me kontrollimin e punës së Ministrisë së Shëndetësisë. Pagat e punëtorëve shëndetësorë janë duke u keqpërdorur. E vetmja mbështetje për punëtorët shëndetësorë është komisioni dhe në fund të fundit komisioni të dalë me propozimin për hartimin e ligjit për kontrollimin e pagave.

Sadik Idriz – Tha se, plani i punës është hartuar në pajtim e strategjinë legjislativë dhe nuk mund të heqim asgjë nga ajo strategji. Nuk kemi informata se pse këto ligje figurojnë në strategjinë legjislativë. Por, pasi që të procedohen në kuvend këto ligje, komisioni mund të dal me mendimin që ky ligj nuk mund të procedohet. Propozoi që të miratohet ky plan. Sa i përket monitorimit të ligjeve, komisioni është shumë i ngarkuar dhe vështirë që mund të bëjë një monitorim kualitativ.

Gjylnaze Syla – Tha se ajo nuk ka propozuar që të hiqen ligjet nga strategjia apo nga plani i punës, por ka kërkuar që komisioni të marrë informata rreth ligjeve që janë paraparë të procedohen në këtë komision. Sa i përket zbatueshmërisë së ligjeve – edhe pse komisioni është shumë i ngarkuar me angazhimin e anëtarëve, të kryetarit dhe të dy nënkryetarëve të komisionit mund të bëjmë këtë.

Flora Brovina – Tha se pajtohet me propozimin e deputetes Teuta Hadri. Është koha që një grup nga komisioni të interesohet për pagesat e punëtorëve shëndetësor. Komision duhet të informohet dhe si mund të informohet nëse nuk është në kontakt të drejtpërdrejtë me burimin e informatës. Ajo tha se nuk heq dorë nga monitorimi i ligjit pavarësisht se komisioni është shumë i ngarkuar. Disa nga ligjet e parapara për procedim janë të kryera dhe nuk duan shumë punë.

Nurishahe Hulaj – Tha se Ligji për duhanin është mirë që është paraparë në strategji legjislative, sepse është një ligj që është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2005. Në vitin 2007 është lëshuar Rregullorja 2007/1 për të qenë ligji i zbatueshëm. Në atë rregullore janë disa gjëra që duhet të inkorporohen në Ligjin për duhanin dhe për këtë arsye konsideroi që ky ligj është proceduar për ndryshim. Në këshillin profesional për kontrollin dhe mbikëqyrjen e Ligjit për duhanin është punuar shumë, janë mbajtur gjithsej 12 mbledhje dhe takime pune për monitorimin ligjit për dhe ligji nuk ka gjet zbatueshmëri. Ne kemi propozuar që të gjitha institucionet publike shëndetësore dhe joshëndetësore të nxjerrin vendim me të cilin ndalohet pirja e duhanit në këto institucione.

Sa i përket Ligjit për inspektoratin e punës është mirë që është futur në plan sipas strategjisë legjislative sepse ne me ligj nuk kemi lejuar propozimin e themelimit të Agjensionit të punës, por jemi pajtuar që të vazhdoi të ekzistoi si inspektorat i punës. Në praktikë, në të gjitha aktivitetet e tij po prezantohet si Agjension i inspektoratit të punës.

Sa i përket Ligjit për shëndetësi edhe ky ligj është mirë që është paraparë që të procedohet këtë vit sepse ka ardhur koha që të ndajmë sektorin publik nga ai privat.

Lidhur me monitorimin e ligjeve, ajo tha se gjatë punës së komisionit do të shohim nëse kemi kohë, mund të propozojmë që të bëjmë monitorimin e një ligji.

Në kuadër të qeverisë janë dy komisione njëri është për kolizionin e ligjeve dhe tjetri për mbikëqyrje. Është mirë të ftohen këto komisione qeveritare në takim.

Teuta Hadri – Tha, para se të realizohet takimi me ministrin e shëndetësisë, komisioni duhet të merr një qëndrim unik sepse Ligji për duhanin është ligj me interes nacional. Duhet të bëjmë presion që ky ligj të kalojë sa më shpejt.

Qamile Morina – Tha se, pajtohet me propozimin e deputetes Gjylnaze Sylja, për nevojën e takimit me ministra, në mënyrë që komisioni ta ketë më të lehtë qasjen ndaj këtyre ligjeve. Komisioni duhet të ketë informatën se cila është esenca e amendamentimit të atyre ligjeve.

Bujar Bukoshi – Lidhur me planin e punës tha se është mjaft i ngjeshur. Propozoi që një muaj të jetë më pak i ngarkuar në mënyrë që të bëjmë një balancë të të gjitha punëve. Kjo do të linte një hapësirë që komisioni të përmbushi atë që nuk arrin gjatë vitit.

Armend Zemaj – Tha se monitorimi i ligjeve është një nga objektivat e komisionit. Propozoi që monitorimi i ligjit të filloi menjëherë në prill në mënyrë që në sesionin pranveror të përfundoi ai monitorim.

Mimoza Ahmetaj – Tha se puna e komisionit nuk është një proces statik, por dinamik. Të shohim, varësisht nga momenti vendosim për monitorimin e ligjeve ose jo.

Pas diskutimeve të deputetëve komisioni nxori këtë

Përfundim

Të formohet një grup punues i cili do të merret me mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes së Sindikatës së shëndetësisë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Qeverinë për shtesën prej 44 euro. Formimi i këtij grupi punues, në plan të punës do të përfshihet në kuadër të vizitave në teren

*Monitorimi i ligjeve gjatë vitit 2009, do të bëhet sipas vlerësimit të komisionit
Takimi me ministrin e shëndetësisë dhe ministrin e punës dhe mirëqenies sociale do të planifikohet të
bëhet në muajin mars.*

4. Të ndryshme

Nurishahe Hulaj – Tha se Ministria e Shëndetësisë është zotuar që përmes të hyrave vetanake do të mbuloi marrëveshjen prej 44 eurove. Meqenëse nuk ka të hyra të mjaftueshme, Qeveria nuk ka ndarë linjë buxhetore për këtë. Ministria e Shëndetësisë ka lëshuar një vendim që 44 euro do të kthehen në përqindje dhe do të futen në listën e pagave, kjo nuk ka ndodhur. Është mirë të bisedojmë me ministrin për këtë çështje sepse është krijuar një konfuzitet edhe për punëtorët shëndetësor.

Qamile Morina - Tha se në takim me përfaqësuesit e ministrisë së shëndetësisë duhet të ftohen për tu dëgjuar edhe Federata sindikale e shëndetësisë dhe përfaqësues nga Qeveria, sepse nënshkruese e marrëveshjes është edhe Qeveria. Për dy muaj Ministria e Shëndetësisë ka bërë pagesën nga të hyrat vetanake. Ministria e Shëndetësisë e ka një memorandum me Ministrinë e Financave dhe deri më tani ka marrë shumë pak nga të hyrat vetanake. Propozoi që të ftohen edhe përfaqësuesit e Qeverisë në mënyrë që të marrim informata nëse pagat e punëtorëve shëndetësor do të rriten si të shërbyesve civil.

Gjylnaze Syla – Tha se komisioni duhet të kërkojë një shkresë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për të marrë informatat se ku është procedura lidhur me këto 44 euro.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz